VENDIM
Nr.3, datë 26.1.2015

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“
Altina Xhoxhaj	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 14.10.2014 mori në shqyrtim, në seancë plenare mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 33/5 Akti, që i përket:

KËRKUES: Hanem Mohamed, Abdelaziz Ibrahim

SUBJEKT I INTERESUAR: Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë

OBJEKTI: Shfuqizimi, si të papajtueshme me Kushtetutën, i vendimeve nr.971, datë 20.07.2009 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr.00-2012-245, datë 08.02.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi).

Dërgimi i çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Apelit Tiranë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f, 134/g të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë dhe nenet 27-30 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes, Vitore Tusha, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkueses, që është shprehur për pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, dhe, pasi bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuesit janë shtetas egjiptianë, të martuar me katër fëmijë, ku më i vogli prej tyre ka shtetësi shqiptare. Ata kanë qëndruar në Shqipëri për 13 vjet, periudhë gjatë së cilës kanë drejtuar organizatat humanitare fetare “Miqësia” dhe “Komiteti i Botës Islame”. Aktiviteti i këtyre organizatave është përqendruar në shpërndarjen e ndihmave ekonomike për jetimët, në organizimin e kurseve dhe të aktiviteteve edukative, si dhe në ndërtimin e objekteve të kultit.

2. Në vitin 2008, kërkuesit paraqitën kërkesë për rinovimin e lejes së qëndrimit, e cila nuk u pranua, por me shkresën nr. 960/1, datë 15.03.2008 të Drejtorisë së Kufirit dhe Emigracionit, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, bazuar në urdhrin nr. 437 të datës 11.03.2008 të Ministrit të Brendshëm, atyre u është komunikuar detyrimi për t’u larguar nga territori i Republikës së Shqipërisë brenda datës 31.03.2008 dhe për të mos hyrë deri në datën 30.03.2018.

3. Kërkuesit, duke qenë se nuk kishin informacion mbi aktin ku bazohej largimi i tyre dhe as mbi provat mbi të cilin ai mbështetej, paraqitën kërkesë në Ministrinë e Brendshme dhe në Drejtorinë Rajonale e Kufirit dhe Emigracionit, por nuk morën asnjë përgjigje.

4. Në këto kushte, kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesëpadi me objekt “Anulimin e urdhrit të ministrit të Brendshëm...”, e cila, me vendimin nr.7120, datë 25.07.2008, ka vendosur pranimin e pjesshëm të kërkesëpadisë dhe anulimin e urdhrit të largimit nga territori i RSH -së.

5. Gjykata e Apelit Tiranë, mbi ankimin e Ministrisë së Brendshme, me vendimin nr.971, datë 20.07.2009, ka vendosur ndryshimin e vendimit të mësipërm dhe rrëzimin e padisë.

6. Gjykata e Lartë, pasi ka marrë në shqyrtim rekursin e paraqitur nga kërkuesit, me vendimin nr.00-2012-245, datë 08.02.2012, ka vendosur mospranimin e tij në dhomë këshillimi.

II

7.*Kërkuesit* i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese në datën 10.02.2014, dukepretenduar shfuqizimin e vendimeve gjyqësore si rezultat i cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, në aspektet e mëposhtme:

7.1 Procesi gjyqësor *nuk ka respektuar kërkesën për t’u zhvilluar brenda afateve të arsyeshme* që përcakton ligji nr. 8492, datë 27.05.1999 “Për të huajt”. Ndonëse procesi gjyqësor duhet të përfundonte brenda 45 ditëve, procesi në Gjykatën e Apelit ka filluar 11 muaj pasi është shpallur vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë, kurse procesi në Gjykatën e Lartë ka zgjatur 2 vjet.

7.2 Është cenuar *parimi i gjykatës së caktuar me ligj*, pasi Gjykata e Apelit Tiranë dhe Gjykata e Lartë e kanë cilësuar aktin administrativ të Ministrit të Brendshëm si akt diskrecial, i cili nuk mund të ankimohet në gjykatë. Urdhri i Ministrit jo vetëm përbën tejkalim të diskrecionit, por është marrë në keqinterpretim të ligjit material dhe në kundërshtim me kërkesat e Kodit të Procedurave Administrative në lidhje me formën, arsyetimin, procedurat e njoftimit dhe parimin e proporcionalitetit.

7.3 Është cenuar *parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, pasi Gjykata e Apelit Tiranë dhe Gjykata e Lartë kanë lënë në fuqi urdhrin e Ministrit të Brendshëm për largimin e kërkuesve në mungesë të provave që provonin bazueshmërinë e kësaj mase, duke e shkarkuar atë nga detyrimi për të vërtetuar ekzistencën e kushteve të refuzimit të lejes së qëndrimit. Edhe shkresa e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë referon në shkresën nr.465/1, datë 28.02.2008 të Shërbimit Informativ Shtetëror, e cila jo vetëm nuk është administruar asnjëherë si provë në procesin gjyqësor, por i mungon arsyetimi, në kundërshtim me nenin 109/1 të KPA-së dhe nenet 4 dhe 5 të ligjit "Për të huajt".

7.4 Gjykata e Apelit Tiranë dhe Gjykata e Lartë kanë cenuar edhe garancitë kushtetuese të parashikuara nga nenet 16 dhe 39 të Kushtetutës dhe detyrimet që burojnë nga sistemi i KEDNJ-së, pasi kanë urdhëruar, përmes një urdhri absurd dhe të pamotivuar, largimin nga RSH-ja të fëmijës më të vogël të kërkuesve, që gëzon shtetësi shqiptare.

7.5 Gjykata e Lartë, në referim të rasteve të përcaktuara nga neni 472 i KPC-së duhet të shprehej nëse në rastin konkret është shkelur ose jo ligji.

8. ***Subjektet e interesuara, Ministria e Brendshme dheDrejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit,*** kanë prapësuar me shkrim se pretendimet e kërkuesve janë të pabazuara, pasi urdhri i ministrit të Brendshëm për largimin e kërkuesve pas mbarimit të afatit të lejes së qëndrimit ka dalë në kushtet e përcaktuara nga neni 46, pika 4 i ligjit nr. 8492, datë 27.05.1999 "Për të huajt". Urdhri është bazuar edhe në informacionin dhe propozimin me shkrim të Drejtorisë të Përgjithshme së Policisë së Shtetit, pasi kjo e fundit, në përputhje me ligjin, është vënë në dijeni të qëndrimit negativ nga Shërbimi Informativ Kombëtar për pajisjen e kërkuesve me leje qëndrimi.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

9. Gjykata sheh të arsyeshme të theksojë, paraprakisht, se pretendimet e kërkuesve ajo i vlerëson në drejtim të standardeve që imponon e drejta për një proces të rregullt ligjor dhe, në kontekstin e çështjes në shqyrtim, në aspektin e detyrimeve që u ngarkon gjykatave të juridiksionit të zakonshëm respektimi i standardeve kushtetuese.

10. Gjykata ka tashmë një qëndrim të konsoliduar sipas të cilit interpretimi i ligjit, zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete, nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimet nr.31, datë 05.07.2011; nr.22, datë 22.07.2009 dhe nr.14, datë 03.06.2009 të gjykatës kushtetuese).*

11. Bazuar në këtë standard dhe nisur nga natyra ligjore e argumenteve ku kërkuesit mbështetin pretendimet mbi cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj dhe të barazisë së armëve e kontradiktoritetit gjatë procesit gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën e Apelit, Gjykata vlerëson se ato kanë të bëjë me vlerësimin e provave, mënyrën e interpretimit të fakteve dhe të zbatimit të ligjit nga ana e asaj gjykate. për rrjedhojë, gjykata çmon se këto pretendime nuk hyjnë në juridiksionin kushtetues.

A. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor

12. Sipas kërkuesve, ndonëse pretendimet e parashtruara në rekurs përfshihen në shkaqet e përcaktuara nga neni 472 i KPC-së, Gjykata e Lartë nuk i ka dhënë përgjigje këtyre pretendimeve.

13. Jurisprudenca kushtetuese ka theksuar se Gjykata e Lartë, për shkak të pozicionit dhe rolit të saj si gjykatë ligji, ka për detyrë të kontrollojë mënyrën e zbatimit të ligjit material dhe procedural nga ana e gjykatave më të ulëta (*shih vendimet nr.35, datë 20.12.2005 dhe nr.14, datë 17.04.2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Po ashtu, Gjykata, referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, ka tashmë një qëndrim të konsoliduar, sipas të cilit kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Një linjë e tillë lidhur me raportin ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, kur është rasti i shqyrtimit nga ana e Gjykatës Kushtetuese të kërkesave individuale, në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës, udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit (komplementaritetit) (*shih vendimet nr. 4, datë 28.02.2006; nr. 19, datë 02.04.2012; nr. 58, datë 24.12.2012;nr. 52, datë 02.12.2013 dhe nr. 3, datë 23.01.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Gjykimi kushtetues synon të vlerësojë nëse procesi, si i tërë, ka qenë i rregullt, duke u ndalur në ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të palëve në proces. Në këtë kuptim, Gjykata duhet të investohet vetëm nëse konstaton shkelje të parimeve të procesit të rregullt ligjor dhe nëse këto shkelje nuk janë konstatuar e riparuar nga Gjykata e

Lartë. Një qëndrim i ndryshëm do ta kthente Gjykatën Kushtetuese në një instancë të zakonshme, gjë që nuk është funksioni i saj (shih vendimet nr. 4, datë 28.02.2006 dhe nr. 19 datë 02.04.2012 të Gjykatës Kushtetuese).

15. Gjykata e ka vlerësuar si cenim të parimit për një proces të rregullt ligjor rastin kur gjykata e shkallës më të lartë, duke u bazuar në kompetencat që i jep Kodi i Procedurës, nuk ka plotësuar ose nuk ka korrigjuar mangësitë dhe gabimet e gjykatave të shkallëve më të ulëta në plotësimin e standardeve dhe elementeve të një procesi të rregullt ligjor (*shih vendimin nr. 5, datë 25.02.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Gjykata ripohon se e drejta për një proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142/1 të Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Funksioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë (*shih vendimet nr. 8, datë 28.02.2012; nr. 8, datë 16.03.2011; nr. 25, datë 10.06.2011 dhe nr. 38, datë 30.12.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Në jurisprudencën e saj, Gjykata ka theksuar domosdoshmërinë e arsyetimit të vendimeve gjyqësore, penale apo civile, si një garanci për procesin ligjor. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Vendimi mund të kontrollohet nga një gjykatë më e lartë sipas procedurave përkatëse dhe, që kjo të jetë e mundur, duhet bërë arsyetimi i vendimit, në të cilin gjyqtari tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm, të cilat e kanë çuar në bërjen e një zgjedhjeje ndërmjet disa mundësive. Vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve në përfundim të gjykimit, përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Ato përmbledhin dhe finalizojnë përfundimisht qëndrimet që mban gjykata lidhur me çështjen në gjykim (*shih vendimet nr. 8, datë 16.03.2011; nr. 23, datë 04.11.2008; nr. 11, datë 02.04.2008 dhenr. 7, datë 09.03.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiksion të hapur apo të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë gjithashtu të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese. Konkluzionet e pjesës arsyetuese duhet të bazohen jo vetëm në aktet ligjore, por edhe në parimet dhe rregullat që karakterizojnë mendimin e shëndoshë e logjik (*shih vendimet nr. 20, datë 13.04.2012 dhe nr. 38, datë 30.12.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Gjithsesi, Gjykata e ka vlerësuar zbatimin e këtij parimi rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre. Ajo ka verifikuar nëse vendimi i kundërshtuar është logjik, ka kundërthënie, përmban referencat në ligjin e zbatueshëm dhe nëse respekton të gjitha elementet e sipërpërmendura. Detyrimi i gjykatave për të respektuar këtë standard ndryshon në varësi të rrethanave të çështjes konkrete dhe natyrës së vendimit dhe masa e arsyetimit varet nga natyra e vendimit në fjalë (*shih vendimin nr.25, datë 10.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Në këtë kontekst, Gjykata ka theksuar se ajo e vlerëson arsyetimin e një vendimi gjyqësor vetëm në kuadrin e përmbushjes ose jo të standardeve të mësipërme, pasi nuk është detyrë e saj të analizojë provat dhe faktet ku është bazuar gjykata për zgjidhjen e çështjes së themelit. Kjo mbetet detyrë funksionale e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm dhe, në aspektin e kontrollit kushtetues, Gjykata verifikon nëse arsyetimi i vendimit gjyqësor i ka plotësuar ose jo kriteret e përcaktuara më sipër, të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Në vlerësimin e Gjykatës nuk mjafton që arsyetimi të jetë formalisht i pranishëm në kuptimin grafik dhe strukturor, pasi kjo do ta bënte atë thjesht fiktiv. Arsyetimi duhet domosdoshmërisht të plotësojë kriteret minimale ligjore të përcaktuara dhe të mos ketë të meta të tilla serioze që cenojnë standardin e vendimit gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimin nr. 55, datë 18.12.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Po në këtë drejtim, neni 310/1 i KPC-së parashikon se vendimi i gjykatës duhet të përmbajë hyrjen, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe pjesën urdhëruese, duke përcaktuar, në paragrafët e tjerë, elementet që duhet të përmenden në secilën prej këtyre pjesëve. Ndërsa për gjykimin në Gjykatën e Lartë, KPC-ja sanksionon se rekursi, ndër të tjera, duhet të përmbajë shkaqet për të cilat kërkohet prishja e vendimit, duke iu referuar normave ligjore

mbi të cilat mbështetet (neni 475/ç) dhe se shqyrtimi i çështjes në kolegjet seleksionuese konsiston në një vlerësim të këtyre shkaqeve. Nëse rekursi bëhet për shkaqe të ndryshme nga ato që i lejon ligji, ai nuk pranohet dhe mospranimi i tij vendoset nga kolegji i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit (neni 480).

22. Nga parashikimet e dispozitave të KPC-së të lartpërmendura, si dhe bazuar në veçoritë e gjykimit në Gjykatën e Lartë dhe në praktikën e saj, Gjykata çmon se në funksion të realizimit të vëzhgimit publik të administrimit të drejtësisë, si dhe të koherencës së vendimit gjyqësor, në mënyrë që përfundimi i procesit të vlerësimit të gjykatës të jetë i mbështetur, përmbajtja e vendimit përbën premisën për përmbushjen e standardit të arsyetimit të vendimit, i cili në këtë drejtim duhet të plotësojë dhe të përmbajë kriteret e përcaktuara nga dispozitat ligjore përkatëse dhe ato të elaboruara nga jurisprudenca kushtetuese e konsoliduar.

23. Në rastin konkret, Gjykata vëren se vendimi i mospranimit i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë përmban, në pjesën hyrëse të tij, objektin e padisë, disponimet e gjykatës së shkallës së parë dhe asaj të apelit dhe faktin se kundër vendimit të kësaj të fundit ka paraqitur rekurs kërkuesi, por nuk përmban shkaqet që ai ka parashtruar në rekurs. Ndërsa në pjesën arsyetuese, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë është mjaftuar me përfundimin se rekursi i paraqitur nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 472 i KPC-së, duke vendosur, në pjesën urdhëruese, mospranimin e tij. Pra, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, pavarësisht se në vendim nuk paraqet cilat janë shkaqet e kundërshtimit të vendimit të apelit, ka arritur të bëjë një proces vlerësimi të tyre (shkaqeve) nëpërmjet të cilit ka arritur në konkluzionin e shprehur në dispozitiv.

24. Nga leximi në tërësi i vendimit, Gjykata vlerëson se për shkakun e lartpërmendur, rrjedha logjike e përdorur në vendim nuk rezulton e qartë dhe e kuptueshme dhe se argumentet e pjesës hyrëse nuk janë të lidhura logjikisht me pjesën arsyetuese dhe atë urdhëruese. Ato nuk formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, çka bën që përmbajtja dhe arsyetimi i tij të mos kenë një harmoni të brendshme. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se mungesa e paraqitjes së shkaqeve të parashtruara në rekurs, në vendimin eKolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, përbën një të metë, të pakapërcyeshme, të përmbajtjes së vendimit dhe të arsyetimit të gjykatës.

25. Gjykata, nisur edhe nga sa u argumentua më lart, çmon gjithashtu se, *prima facie*, mosparaqitja, në vendimin eKolegjit Civil, të shkaqeve të parashtruara nga kërkuesi në rekurs, krijon dyshime edhe mbi cenimin e të drejtës së ankimit efektiv. Në këtë këndvështrim, pasqyrimi i shkaqeve të rekursit në pjesën hyrëse të vendimit të Kolegjit Seleksionues të Gjykatës së Lartë përbën një element të domosdoshëm dhe të rëndësishëm të tij, i cili nuk ka thjesht karakter formal në përmbajtjen e vendimit gjyqësor.

26. Si përfundim, nisur nga sa më sipër, Gjykata çmon se vendimi i mospranimit të rekursit i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, objekt shqyrtimi, nuk ka respektuar standardin kushtetues të arsyetimit të vendimeve gjyqësore. Mungesa e paraqitjes së shkaqeve të parashtruara në rekurs, në vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (dhomë këshillimi), përbën një të metë, të pakapërcyeshme, të përmbajtjes së vendimit dhe të arsyetimit të gjykatës, duke krijuar dyshime edhe për realizimin efektiv të së drejtës së aksesit në gjykatë nga ana e kërkuesve.

27. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuesve në këtë aspekt është i bazuar dhe duhet pranuar.

B. Lidhur me pretendimin për shkeljen e të drejtës për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm

28. Kërkuesit kanë pretenduar cenimin e të drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, si rezultat i moszhvillimit të gjykimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm, duke shkelur standardin e përcaktuar në nenin 42, pika 2, të Kushtetutës. Sipas tyre, procesi gjyqësor nuk ka përfunduar brenda afatit ligjor prej 45 ditësh, sepse procesi në Gjykatën e Apelit ka filluar 11 muaj pasi është shpallur vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë, kurse procesi në Gjykatën e Lartë ka zgjatur 2 vjet.

29. Gjykata ka theksuar se neni 42 i Kushtetutës të Republikës të Shqipërisë, si dhe neni 6 i KEDNJ-së vendosin detyrimin për organizimin e sistemit ligjor, në mënyrë të tillë që gjykatat të plotësojnë kërkesat e standardeve për një proces të rregullt ligjor, përfshirë këtu edhe atë të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm. Gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë për detyrë të sigurojnë që të gjitha subjektet që marrin pjesë në proces të sillen në mënyrë të tillë që të evitojnë çdo vonesë të panevojshme. Kjo detyrë e gjykatave gjen rregullim në nenet 4 dhe 171/a të Kodit të Procedurës Civile, të cilat përcaktojnë se "*gjykata kujdeset për zhvillimin e rregullt të procesit gjyqësor.....*" dhe "*gjykata ushtron të gjitha të drejtat e përcaktuara në këtë Kod, që janë të nevojshme për zhvillimin sa më të mirë të procesit gjyqësor. Gjykata cakton seancat dhe afatet brenda të cilave palët dhe personat e tjerë të thirrur prej saj duhet të kryejnë aktet procedurale dhe veprimet e tjera të kërkuara prej saj.*

30. Po ashtu, Gjykata ka theksuar se për sa i përket sjelljes së autoriteteve, edhe pse kuadri procedural civil ka parashikuar parimin se iniciativat procedurale u takojnë palëve, kjo nuk i shkarkon

gjykatat nga detyrimi për të siguruar një gjykim të shpejtë, siç kërkon neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6/1 i KEDNJ-së (*shih vendimin nr.12, datë 05.03.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Për të vlerësuar pretendimet e individëve në lidhje me mosrespektimin nga gjykatat e zakonshme të kërkesës për gjykimin e çështjes brenda afatit të arsyeshëm, Gjykata është mbështetur në mënyrë të vazhdueshme në kriteret e përcaktuara nga GJEDNJ-ja, të reflektuara më pas edhe në praktikën e saj të konsoliduar në këtë drejtim. Sipas këtyre kritereve, arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procesit gjyqësor duhet të vlerësohet në dritën e rrethanave të veçanta të çështjes, duke pasur parasysh sidomos kompleksitetin e çështjes, sjelljen e kërkuesit, sjelljen e autoriteteve, si dhe rrezikun që sjell për kërkuesin kjo tejzgjatje e afateve të gjykimit (*shih vendimin nr.12, datë 05.03.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

32. Duke iu rikthyer çështjes konkrete, Gjykata vëren se ligji i zbatueshëm për zgjidhjen e çështjes në fjalë ka qenë ligji nr.8492, datë 27.05.1999 "Për të huajt". Në nenin 56 të këtij ligji parashikohej se kundër vendimit të refuzimit ose urdhrit të largimit të dhënë mbas shqyrtimit nga organi administrativ, mund të bëhet ankim në gjykatë brenda 8 ditëve pas vendimit më të fundit administrativ, në rast se i huaji ka pasur qëndrim të ligjshëm jo më pak se një vit në RSH-së. Për çështjet e imigracionit, për të cilat bëhet ankim në gjykatë, zbatohen rregullat e parashikuara nga Kodi i Procedurës Civile. Megjithatë, për vetë karakterin e këtyre lloj çështjeve, shqyrtimi në të gjitha shkallët e gjykimit nuk mund të kalojë më shumë se 45 ditë (30 ditë gjykata e rrethit e 15 ditë gjykata e apelit).

33. Lidhur me periudhën *e kohës që duhet marrë në konsideratë*, Gjykata, referuar materialeve të dosjes gjyqësore, konstaton se procesi gjyqësor në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka përfunduar në datën 25.07.2008, kur gjykata ka vendosur pranimin e pjesshëm të kërkesëpadisë. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim pala e paditur, Ministria e Brendshme. Kopje e ankimit i është njoftuar kërkuesve me dëftesën e komunikimit të datës 27.08.2008. Sipas ekstraktit të printuar nga faqja elektronike e Gjykatës së Apelit (fq.1 e fashikullit gjyqësor), rezulton se ankimi është regjistruar në datën 17.11.2008, kurse në datën 07.01.2009 shënohet: "*...me urdhër të brendshëm të Kryetarit të Gjykatës së Apelit të datës 24.12.2008 ndryshohen trupat gjykues dhe çështjet rishpërndahen me short të ri elektronik...*" Seanca e parë gjyqësore në Gjykatën e Apelit është zhvilluar në datën 25.06.2009 dhe procesi ka përfunduar në datën 20.07.2009, kur gjykata ka vendosur ndryshimin e vendimit dhe rrëzimin e kërkesë padisë. Në datën 20.08.2009, kërkuesit kanë depozituar rekurs në Gjykatën e Lartë, e cila, pasi e ka shqyrtuar në dhomë këshillimi, në datën 08.02.2012, ka vendosur mospranimin e rekursit.

34. Për kompleksitetin e çështjes, Gjykata është shprehur se për vlerësimin e këtij elementi të procedimeve duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshi objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara dhe volumin e provave shkresore. Kompleksiteti i çështjes, në balancë me parimin e sigurimit të administrimit të përshtatshëm të drejtësisë, mund të justifikojë kohëzgjatje kohore të konsiderueshme (*shih vendimet nr. 50, datë 22.11.2011; nr. 7, datë 27.02.2012 dhe nr.43, datë 07.07.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

35. Në rastin konkret Gjykata konstaton se gjykimi i iniciuar prej kërkuesve, i cili ka pasur për objekt anulimin e aktit administrativ të Urdhrit të Ministrit të Brendshëm, është i natyrës administrative. Ky gjykim rregullohet nga dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative, të Kodit të Procedurës Civile mbi gjykimet e posaçme (nenet 324 e vijues) dhe ligji nr.8492, datë 27.05.1999 "Për të huajt".

36. Nga sa më sipër, Gjykata vlerëson se, duke pasur parasysh natyrën e tij, gjykimi nuk paraqitet me natyrë komplekse. Në këto kushte, procedura e ndjekur për rihedhjen e shortit në Gjykatën e Apelit nuk duhet të bëhej shkak për zgjatjen e procesit tej afatit ligjor 15-ditor në Gjykatën e Apelit Tiranë, në referim të kërkesave të nenit 56 të ligjit "Për të huajt".

37. *Për sa i përket sjelljes së kërkuesve*, referuar kronologjisë së proceseve gjyqësore, Gjykata vlerëson se paraqitja njëkohësisht e të dyja kërkesëpadive nuk ka shkaktuar vonesa të pajustifikuara për zhvillimin e gjykimit. Përkundrazi, paraqitja e kërkesës për bashkimin e procedimeve dhe prania e vazhdueshme në të gjitha seancat e zhvilluara tregon qartazi përpjekjet për të përshpejtuar procesin gjyqësor. Në këtë drejtim, Gjykata ripohon se, për sa i përket sjelljes së kërkuesve, përdorimi nga ana e tyre i të gjitha procedurave të parashikuara nga e drejta e brendshme, me qëllim sigurimin e mbrojtjes, nuk mund të përdoret si argument kundër tyre (*shih vendimet nr.9, datë 1.04.2009 dhe nr.12, datë 05.03.2012 të Gjykatës Kushtetuese).*

38. *Për sa i përket sjelljes së autoriteteve publike,* nga materialet e administruara në dosjen gjyqësore rezulton se nga dita e paraqitjes së kërkesëpadisë (2008), deri në momentin e dhënies së vendimit të Gjykatës së Lartë (2012) kanë kaluar gati katër vjet. Gjykata, referuar sa më sipër, vlerëson se gjykatat e dy shkallëve të para, për shkak të mosmarrjes së masave të nevojshme dhe të domosdoshme për gjykimin brenda afatit ligjor 45 ditësh, nuk e kanë respektuar kërkesën për gjykimin e kësaj çështjeje

në përputhje me standardin e procesit të rregullt ligjor të shqyrtimit të çështjes brenda afatit të arsyeshëm. Ndonëse cenimi i këtij standardi është pretenduar edhe në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë, kjo mangësi e procesit nuk është konstatuar dhe as është korrigjuar nga Gjykata e Lartë.

39. Në vështrim të sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se bazuar në llojin dhe natyrën e mosmarrëveshjes në gjykim, kërkuesve Hanem Mohamed dhe Abdulaziz Ibrahim iu është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e moszhvillimit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë.

40. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesve janë pjesërisht të bazuara dhe duhen pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, shkronja "f" dhe 134, pika 1, shkronja "g", të Kushtetutës dhe neneve 72 dhe 77 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

VENDOSI:

-Pranimin pjesërisht të kërkesës.

-Konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, si rezultat i mosgjykimit të çështjes brenda afatit të arsyeshëm.

-Shfuqizimin e vendimitnr. 00-2012-245, datë 08.02.2012 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

-Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar),Sokol Berberi,Vladimir Kristo,Fatmir Hoxha,Besnik Imeraj,Gani Dizdari

Anëtare kundër: Altina Xhoxhaj,Vitore Tusha

MENDIM PARALEL

1. Gjykata Kushtetuese (Gjykata) ka pranuar pjesërisht pretendimet e kërkuesve, Hanem Mohamed dhe Abdelaziz Ibrahim, dhe ka shfuqizuar si të papajtueshëm me Kushtetutën vendimin nr. 00-2012-245, datë 08.02.2012të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. Pavarësisht se në qëndrimin përfundimtar pajtohem me vendimin e shumicës, cenimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor në procesin e zhvilluar në Gjykatë të Lartë e shoh edhe nën një këndvështrim tjetër.

2. Gjykata, referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, ka tashmë një qëndrim të konsoliduar, sipas të cilit kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Një linjë e tillë, lidhur me raportin ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, kur është rasti i shqyrtimit nga ana e Gjykatës Kushtetuese të kërkesave individuale, në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës, udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit (komplementaritetit) (*shih vendimet nr. 4, datë 28.02.2006 dhe nr. 19, datë 02.04.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

3. Në këtë kuptim, Gjykata duhet të investohet vetëm nëse konstaton shkelje të parimeve të procesit të rregullt ligjor dhe nëse këto shkelje nuk janë konstatuar e riparuar nga Gjykata e Lartë. Në rast se Gjykata nuk arrin në një përfundim të tillë, pra që procesi i zhvilluar në të tria shkallët e gjykimit është i cenueshëm nga pikëpamja kushtetuese, mendoj se ajo nuk mundet të shfuqizojë një vendim të Gjykatës së Lartë, vetëm me arsyetimin se ai nuk përmban shkaqet e paraqitura në rekurs.

4. Lidhur me cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, sikurse jam shprehur edhe më parë (*shih mendimin paralel të vendimeve nr. 31, datë 10.07.2013; nr.26, datë 24.06.2013; nr. 22, datë 20.05.2013 dhenr. 3, datë 19.02.2013 të Gjykatës Kushtetuese)*,paraqitja formale (ndonëse e nevojshme) e pretendimeve në pjesën hyrëse të vendimit të Gjykatës së Lartë, në vlerësimin tim, megjithëse shërben për të ndrequr një mangësi në formulimin e vendimeve nga Kolegjet e Gjykatës së Lartë, mbetet skematike dhe e padobishme, pa vlerësuar atë që është më e rëndësishme në një vendim gjyqësor, pikërisht pjesën arsyetuese, e cila lidhet drejtpërdrejt me standardin kushtetues të arsyetimit të vendimit. Një qëndrim i tillë i shumicës, mbi të gjitha, jo vetëm anashkalon jurisprudencën e kësaj Gjykate lidhur me unitetin dhe logjikën e vendimit në të gjitha elementet përbërëse të tij, por edhe nuk i shërben aspak kërkuesve, të cilët pretendimet e tyre për proces të parregullt ligjor i lidhin me cenimin e të drejtave të tyre kushtetuese.

5. Në vlerësimin tim, mungesa në vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë e pjesës arsyetuese, pa nënvlerësuar aspak pjesët e tjera të tij të cilat së bashku përbëjnë një unitet, cenon në thelb standardin e arsyetimit të vendimit. Mungesa e kësaj pjese, nga ana tjetër, i heq mundësinë Gjykatës për të vlerësuar nga pikëpamja

kushtetuese pretendimet e kërkuesve në raport me vendimmarrjen e gjykatës më të lartë të sistemit të juridiksionit të zakonshëm. Një qëndrim i kundërt, si në rastin në fjalë, jo vetëm bie ndesh me Kushtetutën dhe standardin e vendosur nga kjo Gjykatë, por, njëkohësisht, e bën vendimmarrjen e saj formale dhe aspak efektive.

6. Duke shkuar më tej, rasti konkret paraqet si veçori edhe ekzistencën e dy vendimeve të kundërta të gjykatave të faktit në zgjidhjen e konfliktit konkret. Personalisht jam shprehur mbi këtë rrethanë (*shih mendimin e pakicës të vendimit nr. 34, datë 12.07.2013),* por edhe Gjykata ka mbajtur qëndrim duke theksuar se roli i Gjykatës së Lartë, si gjykatë e ligjit, është i një natyre të pazëvendësueshme. Ajo i ka të gjitha mjetet dhe kompetencat për të pasur një rol aktiv që shkon përtej ligjit dhe synon të drejtën, duke ndikuar efektivisht edhe në vendimmarrjen e gjykatave të shkallëve më të ulëta, veçanërisht në rastet kur dy gjykata u kanë dhënë përgjigje diametralisht të kundërta pretendimeve të kërkuesit. Nga kjo pikëpamje, Gjykata ka vlerësuar se në të tilla raste (që shqyrtohen rast pas rasti) kërkuesi, duke mos marrë përgjigje për pretendimet e tij me natyrë kushtetuese për shkak të vendimit të mospranimit të rekursit, i cenohet e drejta e ankimit në kuptimin substancial, e parashikuar në nenin 43 të Kushtetutës (*shih vendimin nr. 3, datë 05.02.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Për pasojë, mendoj se edhe në çështjen në shqyrtim, Gjykata e Lartë duhej të mbante qëndrim të shprehur qoftë edhe për të përmbushur detyrimin për unifikim të praktikës gjyqësore.

7. Gjithashtu vlerësoj se Gjykata e Lartë duhej t'i jepte përgjigje edhe pretendimit tjetër të kërkuesve lidhur me cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe kondradiktoritetit. Kërkuesit pretendojnë se gjykata e apelit ka lënë në fuqi urdhrin e ministrit të Brendshëm për largimin e tyre në mungesë të provave përkatëse, ndërsa vendimet gjyqësore referojnë në shkresën nr.465/1, datë 28.02.2008 të Shërbimit Informativ Shtetëror, e cila nuk është administruar asnjëherë si provë në procesin gjyqësor, si dhe i mungon arsyetimi, në kundërshtim me nenin 109/1 të KPA-së dhe nenet 4-5 të ligjit "Për të huajt".

8. Në vështrim të jurisprudencës së GJEDNJ-së, mosinformimi i aplikantit (shtetas i huaj rezident në përputhje me ligjin) mbi shkakun e dëbimit nga autoritetet kombëtare si dhe vlerësimi thjesht formal i shkaqeve të dëbimit nga gjykatat, është vlerësuar si cenim i të drejtës së mbrojtjes, në drejtim të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit. Këto situata janë analizuar në raport me parashikimet e nenit 8 të KEDNJ-së "E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare", nenit 3 "Ndalimi i dëbimit të shtetasve" dhe nenit 4 "Ndalimi i dëbimit kolektiv të të huajve" të protokollit 4, si dhe nenit 1 "Garancitë procedurale në lidhje me dëbimin e të huajve" të Protokollit 7 të KEDNJ-së.

9. Në çështjet *C.G. and Others v. Bulgaria (24/07/2008) dhe Lupsa v. Romania (08/09/2006)*, GJEDNJ-ja është shprehur se: "*gjykatat kombëtare pretendimin e ekzekutivit se aplikanti përbënte rrezik për sigurinë kombëtare nuk ia nënshtruan një hetimi të kujdesshëm dhe të plotë*" (Lupsa, § 41; *C.G. and Others*, § 44). Akti i dëbimit të tyre citon vetëm normat ligjore të zbatueshme dhe përmend faktin se aplikanti përbën rrezik për sigurinë kombëtare. Një përfundim i tillë ishte bazuar në një informacion të paspecifikuar në përmbajtje të një dokumenti sekret të brendshëm. Në mungesë të njohurive mbi faktet kryesore që shërbyen si bazë për këtë vlerësim, aplikanti nuk ka qenë në gjendje të kundërshtojë çështjen në mënyrë të përshtatshme përpara Ministrit të Punëve të Brendshme dhe as në procedurat gjyqësore (*C.G. and Others*, § 45). Ndonëse aplikantit i është dhënë mundësia e kundërshtimit të aktit administrativ në gjykatë, ai nuk ka gëzuar minimumin e mbrojtjes kundër arbitraritetit *(Kaushal and Others v. Bulgaria, 02/12/2010, § 27).*

10. Edhe kur bëhet fjalë për çështjen e sigurisë kombëtare, konceptet e ligjshmërisë dhe të shtetit të së drejtës në një shoqëri demokratike kërkojnë që masat të cilat ndikojnë mbi të drejtat dhe liritë themelore duhet t'u nënshtrohen procedurave të kontradiktoritetit përpara një organi të pavarur kompetent për rishikimin e arsyeve të vendimit dhe të provave që lidhen me të edhe në ato raste kur zbatohen kufizime procedurale në përdorimin e materialit të klasifikuar *(Kaushal and Others v. Bulgaria, 02/12/2010, § 29).*

11. Nga sa më sipër, çmoj se vlerësimi i rrethanave të çështjes konkrete nën dritën e jurisprudencës së GJEDNJ-së, duke marrë në konsideratë edhe faktin se një prej fëmijëve të kërkuesve ka shtetësi shqiptare, si dhe në kuadër të garancive kushtetuese që duhet të gëzojnë shtetasit e huaj për të mos u dëbuar kolektivisht, passillte detyrimin për Gjykatën e Lartë që t'i jepte përgjigje edhe këtij pretendimi të kërkuesve.

12. Si përfundim, duke pasur parasysh edhe problematikat e shumta me natyrë ligjore në një çështje delikate si ajo në shqyrtim, cenimin e parimeve kushtetuese të lartpërmendura si dhe moszhvillimin e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, sikurse ka konstatuar edhe shumica, jam i mendimit se Gjykata e Lartë, në funksion të rolit të saj si gjykatë e ligjit, si dhe të kontrollit në respektimin e standardeve kushtetuese nga gjykatat më të ulëta, duhet të mbante, në rastin konkret,

qëndrim të shprehur, në respekt të së drejtës së aksesit në gjykatë dhe të parimit të arsyetimit të vendimit gjyqësor. Në këtë mënyrë, Gjykata e Lartë do të realizonte efektivisht edhe të drejtën kushtetuese të kërkueseve për të pasur një ankim substancial në një gjykatë më të lartë, në kuptim të nenit 43 të Kushtetutës.

13. Për rrjedhojë, në këtë këndvështrim, mendoj se vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë është rezultat i një procesi të parregullt ligjor dhe si i tillë duhej të shfuqizohej.

Anëtar: Vladimir Kristo

MENDIM PAKICE

Për arsye se nuk ndaj të njëjtin qëndrim me shumicën lidhur me përfundimin e arritur në këtë çështje dhe argumentet mbi të cilat mbështetet ky qëndrim, e çmoj të rëndësishme të shprehem me mendim pakice.

1. Nga rrethanat e çështjes rezulton se kërkuesit janë shtetas egjiptianë, rezident të ligjshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë, të pajisur me leje qëndrimi dhe pune për një periudhë të caktuar kohore, në përputhje me kërkesat të ligjit nr. 8492, datë 27.05.1999 "Për të huajt". Në fillim të vitit 2008, kur kërkuesit kanë paraqitur kërkesë për rinovimin e lejes së qëndrimit, u është komunikuar detyrimi për t'u larguar nga territori i Republikës së Shqipërisë brenda datës 31.03.2008 dhe për të mos hyrë në të deri në datën 30.03.2018.

2. Urdhri i largimit, pas ankimit administrativ, është bërë objekt i shqyrtimit gjyqësor në tria shkallët e gjykimit të zakonshëm. Gjithashtu, mbrojtësi i kërkuesve ka paraqitur një ankim individual edhe në Gjykatën Kushtetuese. Kjo e fundit ka pranuar pjesërisht kërkesën duke konstatuar cenimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor në drejtim të mosgarantimit të standardit të arsyetimit të vendimit nga Gjykata e Lartë, për shkak të mosreflektimit të shkaqeve të rekursit në vendimin e moskalimit dhe, po ashtu, në drejtim të mosgjykimit të çështjes brenda afatit të arsyeshëm.

3. Nëse u referohemi garancive që gëzojnë shtetasit e huaj me qëndrim të rregullt në Shqipëri, konstatohet se fillimisht ato kanë qenë objekt rregullimi nga ligji nr. 8492, datë 27.05.1999 "Për të huajt" dhe aktualisht nga ligji nr. 108/2013. Kuadri ligjor reflekton standardet dhe garancitë e parashikuar në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), dhe në Direktivat e Bashkimit Evropian. Këto garanci janë të zbatueshme gjatë hyrjes, qëndrimit, largimit ose dëbimit të shtetasve të huaj në përputhje me vendimet e autoriteteve të përcaktuara nga ligji. Për më tepër, kuadri ligjor parashikon të drejtën për të kundërshtuar urdhrin e largimit në rrugë administrative dhe gjyqësore.

4. Kërkuesit, duke qenë individë të cilët kërkojnë shfuqizimin e vendimeve gjyqësore pasi kanë shteruar mjetet juridike në dispozicion *prima facie* duket se legjitimohen *ratione personae, ratione tempore dhe ratione materia.* Pavarësisht këtij konstatimi, nisur nga natyra e vendimeve gjyqësore objekt kundërshtimi, mendoj se shumica duhet të vlerësonte paraprakisht faktin nëse vendimet lidhur me hyrjen, qëndrimin dhe dëbimin e të huajve kanë të bëjnë me përcaktimin e të drejtave ose detyrimeve civile të tyre ose të një akuze penale kundër tyre, në kuptim të garancive kushtetuese të përcaktuar nga nenet 42 e të tjerë të Kushtetutës dhe neni 6§1 i KEDNJ-së, dhe, për rrjedhojë, nëse janë të zbatueshme në këto raste.

5. Në referim të jurisprudencës kushtetuese, teksti i Konventës dhe jurisprudenca e Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) shërbejnë për të bërë interpretimin kushtetues dhe për të përcaktuar, rast pas rasti, kufijtë e të drejtave themelore kushtetuese. Jurisprudenca e GJEDNJ-së gëzon një status ekskluziv në sistemin tonë të brendshëm juridik, e cila është pranuar si e tillë për efekt të zbatimit te nenit 122 të Kushtetutës, po edhe të nenit 17/2 të saj, të cilët sjellin si detyrim që vendimet e GJEDNJ-së të zbatohen drejtpërsëdrejti. Me rastin e ratifikimit të KEDNJ-së, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, si përfaqësues i sovranitetit popullor, ka marrë përsipër detyrime të cilat janë të zbatueshme nga të gjitha organet shtetërore të Republikës së Shqipërisë, përfshirë gjykatat e të gjitha niveleve, pavarësisht llojit të tyre *(shih vendimin nr.20, datë 01.06.2011 të Gjykatës Kushtetuese)*

6. Çështjet e dëbimit të shtetasve të huaj rezidentë të ligjshëm janë bërë objekt shqyrtimi edhe nga GJEDNJ-ja. Në jurisprudencën e saj mbizotëron qëndrimi se të huajt rezidentë të ligjshëm në territorin e një shteti, në rastin e dëbimit, krahas mbrojtjes së përcaktuar në nenet 3, 8 dhe 13 të KEDNJ-së, përfitojnë edhe nga garancitë e veçanta të parashikuara në nenin 1 të Protokollit nr. 7, kur shteti në fjalë e ka ratifikuar atë *(shih vendimet Lupsa, §§ 51 - 52; Kaya kundër Rumanisë, nr. 33970/05, §§ 51 dhe 52, 12 tetor 2006, si dhe Bolat kundër Rusisë, nr. 14139/03, § 76, GJEDNJ 2006-XI).*

7. Protokolli 7 i KEDNJ-së, në nenin 1 të tij përcakton se garancitë procedurale gjejnë zbatim për shtetas të huaj me qëndrim të rregullt në territorin e një shteti, që nuk mund të dëbohen, veçse në zbatim të një vendimi të marrë në përputhje me ligjin dhe duhet të kenë mundësi: (a) të parashtrojnë arsyet kundër dëbimit të tyre; (b) të

kërkojnë shqyrtimin e çështjes së tyre; (c) të përfaqësohen për këto qëllime përpara autoritetit kompetent ose të një ose disa personave të caktuar nga ky autoritet. Një i huaj mund të dëbohet përpara ushtrimit të të drejtave të mësipërme, kur ky dëbim është i domosdoshëm në interes të rendit publik ose kur është bërë për arsye të sigurisë kombëtare.

8. Duke analizuar jurisprudencën e GJEDNJ-së mbi këtë kategori çështjesh konstatohet se deri në vitin 2000 nuk ishte marrë në shqyrtim zbatueshmëria e nenit 6§1 të KEDNJ-së në procedurat për dëbimin e të huajve. Ndërkohë, Komisioni ka shprehur vazhdimisht mendimin se vendimi që do të autorizojë një të huaj për të qëndruar në një vend në të cilin ai nuk është shtetas, nuk passjell përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, brenda kuptimit të nenit 6 § 1 të Konventës *(shih vendimet e Komisionit Uppal dhe Singh kundër Mbretërisë së Bashkuar, 2 maj 1979; Bozano kundër Francës, 15 maj 1984; Urrutikoetxea kundër Francës, 5 dhjetor 1996 dhe Kareem kundër Suedisë, 25 tetor 1996).*

9. Duke filluar nga viti 2000, kur GJEDNJ-ja mori vendimin *Maaouia kundër Francës,*në vijimësi ajo rithekson qëndrimin se vendimet lidhur me hyrjen, qëndrimin dhe dëbimin e të huajve nuk kanë të bëjnë me përcaktimin e të drejtave ose detyrimeve civile të dikujt ose të një akuze penale kundër aplikantit, në kuptim të nenit 6 § 1 të Konventës. Si pasojë, neni 6 § 1 nuk është i zbatueshëm në këto raste.

10. Në këto vendimmarrje GJEDNJ-ja rithekson se konceptet e "të drejtave civile dhe detyrimeve" dhe "akuzës penale", nuk mund të interpretohen vetëm duke iu referuar ligjit të brendshëm të shtetit të paditur. Në disa raste GJEDNJ-ja ka pohuar parimin se këto koncepte janë "autonome", në kuptim të nenit 6 § 1 të Konventës *(shih, midis të tjerash, König kundër Gjermanisë, 28 qershor 1978, §§ 88-89; Baraona kundër Portugalisë, 8 korrik 1987, § 42 dhe Malige kundër Francës, 23 shtator 1998, § 34).*

11. Në jurisprudencën e GJEDNJ-së konstatohet qëndrimi se dispozitat e Konventës duhet të interpretohet në dritën e të gjithë sistemit të Konventës, duke përfshirë Protokollet. Nisur nga ky qëndrim, GJEDNJ-ja vëren se neni 1 i Protokollit nr 7 është një instrument që u miratua më 22 nëntor 1984 dhe që përmban garancitë procedurale të zbatueshme për dëbimin e të huajve. Përveç kësaj, preambula e atij instrumenti i referohet nevojës për të ndërmarrë "hapa të mëtejshëm për të siguruar garancinë kolektive të të drejtave dhe lirive të caktuara me anë të Konventës ... ". Të marra së bashku, ato dispozita, sipas vlerësimit të GJEDNJ-së tregojnë se Shtetet ishin të vetëdijshme se neni 6§1 nuk zbatohet për procedurat për dëbimin e të huajve dhe dëshironin që të merrnin masa të veçanta në këtë sferë.

12. Përveç sa më sipër, edhe raporti shpjegues i Protokolli nr.7, në seksionin mbi nenin 1, shprehet si më poshtë: "*6 . ... një i huaj, në mënyrë të ligjshme, në territorin e një shteti anëtar të Këshillit të Evropës tashmë përfiton nga garancitë e caktuara kur ndaj tij është marrë një masë e dëbimit, sidomos ato të cilat janë përcaktuar nga nenet 3 (Ndalimi i trajtimit çnjerëzor ose degradues) dhe 8 (E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare), në lidhje me nenin 13 (E drejta për një ankim efektiv përpara një instance kombëtare) të Konventës, siç interpretohet nga Komisioni Evropian dhe Gjykata e të Drejtave të Njeriut ...Duke marrë në konsideratë të drejtat të cilat janë të njohura në këtë mënyrë në favor të të huajve, ky nen i Konventës është shtuar në mënyrë që të përballojë garanci minimale të personave të tillë në rastin e dëbimit nga territori i një Palë Kontraktuese. Shtimi i këtij neni mundëson që mbrojtja të jepet në ato raste të cilat nuk mbulohen nga instrumente të tjera ndërkombëtare dhe lejon një mbrojtje të tillë që përfshihet në fushëveprimin e sistemit të kontrollit të parashikuar në ... Konventë".*

13. GJEDNJ-ja mban qëndrimin se duke miratuar nenin 1 të Protokollit nr.7, që përmban garanci në mënyrë specifike në lidhje me procedurat për dëbimin e të huajve, Shtetet shprehën qartë qëllimin e tyre për të mos përfshirë procedurat e tilla brenda fushës së nenit 6§1 të Konventës. Në dritën e sa më sipër, vlerësohet se procedurat për anulimin e urdhrit të dëbimit, të cilat formojnë lëndën e çështjeve objekt shqyrtimi, nuk kanë të bëjnë me përcaktimin e një "të drejte civile" për qëllime të nenit 6 § 1. Fakti që urdhri i dëbimit rastësisht pati pasoja të mëdha në jetën private dhe familjare të kërkuesit ose mbi perspektivat e tij të punës, nuk mund të mjaftojë për të sjellë ato procedime brenda fushës së të drejtave civile të mbrojtura nga neni 6§1 i Konventës (*shih, mutatis mutandis, Neigel kundër Francës, 17 marsit 1997, §§ 43-44 dhe Maillard kundër Francës, 9 qershor 1998, §§ 39-41*).

14. Gjithashtu, GJEDNJ-ja rikonfirmon qëndrimin se urdhrat për dënimin e të huajve nga territori i një shteti nuk kanë të bëjnë as me përcaktimin e një akuze penale. Në këtë kuptim, ajo vëren se karakterizimi i tyre në kuadër të rendit juridik të brendshëm është i hapur ndaj interpretimeve të ndryshme. Në çdo rast, karakterizimi nga rendi vendor ligjor i dëbimit nuk mund, në vetvete, të jetë vendimtar për të përcaktuar nëse dënimi është kriminal në natyrë. Faktorë të tjerë, sidomos natyra e dënimit në fjalë, duhet të merren në konsideratë (*shih Tyler kundër Mbretërisë së Bashkuar, aplikimi nr. 21283/93, vendim i Komisionit, 5 prill 1994, DR 77, f. 81-86*).

15. Në përgjithësi, urdhrat e dëbimit nuk janë të klasifikuara si kriminale brenda Shteteve anëtare të Këshillit të Evropës. Urdhra të tilla, të cilat në shumicën e shteteve mund edhe të bëhen nga autoritetet administrative, përbëjnë një masë të posaçme parandaluese për qëllime të kontrollit të emigracionit dhe nuk kanë të bëjnë me përcaktimin e një akuze penale kundër ankuesit për qëllime të nenit 6 § 1. Fakti që ato janë vendosur në kontekstin e procedurave penale nuk mund të ndryshojë natyrën e tyre në thelb parandaluese. Procedurat për anulimin e masave të tilla nuk mund të konsiderohen se i përkasin sferës penale *(shih, mutatis mutandis, Renna kundër Francës, aplikimi nr. 32809/96, vendimi i Komisionit i datës 26 shkurt 1997, i paraportuar).*

16. Duke iu rikthyer çështjes konkrete, nisur nga natyra e pretendimeve të parashtruara përpara Gjykatës Kushtetuese nga kërkuesit, vlerësoj se qëndrimi i mbajtur nga GJEDNJ-ja gjen zbatim edhe në rastin objekt shqyrtimi. Proceset të cilat lidhen me kontrollin e migracionit nuk përbëjnë çështje civile dhe as akuzë penale në vështrim të përcaktimeve të nenit 6 të KEDNJ-së ose nenit 42 të Kushtetutës shqiptare. Aktet e dëbimit, të cilat kundërshtohen administrativisht dhe gjyqësisht, i përkasin të drejtës publike dhe përfaqësojnë ushtrimin e prerogativave të pushtetit publik.

17. Bazuar në arsyetimin e mësipërm, ndryshe nga sa ka vendosur shumica, mendoj se pretendimet e kërkuesve për cenimin e garancive të procesit të rregullt ligjor nuk përfshihen në juridiksionin kushtetues dhe, për rrjedhojë, kërkesa duhet të ishte rrëzuar.

Anëtare: Vitore Tusha